## ÇERTIFIKATA E PËRDORIMIT

ÇERTIFIKATA E PËRDORIMIT
është dokument i lëshuar nga
Komuna/Drejtoria e Urbanizmit, që vërteton se
ndërtimi është i përshtatshëm për përdorim.

## SI TË APLIKONI

1. Inspektimi përfundimtar i ndërtimit

***Brenda 15 dite pas miratimit***

2. Dorëzoni kërkesën/aplikacionin për çertifikatën e përdorimit/çertifikatën e përkohshme të përdorimit në Drejtorinë e urbanizmit

3. Ju do të informoheni për miratimin e kërkesës/aplikacionit përmes telefonit, postës apo emailit

**Brenda 15 dite (kat.I) dhe**
**30 dite (kat. II dhe III)**

***Për më shumë informata lidhur me dokumentet dhe procedurat e nevojshme, ju lutemi vizitoni Komunën/Zyrën e Drejtorisë së Urbanizmit.***

## LIGJI PËR NDËRTIM

Ligji për Ndërtim rregullon procesin e ndërtimit si përgatitjen e projektit, ndërtimin, rindërtimin dhe rrënimin.

Ligji për Ndërtim poashtu përcakton të drejtat, obligimet e qytetarëve dhe autoriteteve si dhe siguron kualitetin e ndërtimeve.

Me qëllim të sigurimit të kualitetit të ndërtimeve dhe shmangies nga dënimet dhe rrënimi:

- Qytetari duhet të ketë Lejen ndërtimore para se të filloj ndërtimin; dhe
- Qytetari duhet të ndërtoj objektin sipas kërkesave të Lejes ndërtimore.

## LLOJET E NDËRTIMIT PËR TË CILAT KËRKOHET LEJA NDËRTIMORE

NDËRTIM I RI

RINDËRTIMI I OBJEKTEVE EKZISTUESE

RRËNIMI I OBJEKTEVE EKZISTUESE

RIPARIMI I OBJEKTIT NDËRTIMOR

INTERVENIMET NË FASADAT DHE STRUKTURËN (SANIMET) E NJË OBJEKTI EKZISTUES


**PROGRAMI PËR MBËSHTETJE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL**

Komuna e Mamushës

*Implementuar nga:* UN-HABITAT FOR A BETTER URBAN FUTURE

*Financuar nga:* ***SWEDISH DEVELOPMENT COOPERATION*** SWEDEN


KOMUNA E MAMUSHËS

# INFORMATA MBI NDËRTIMIN NË MAMUSHË



**Për ndërtimin e çfarëdo strukture si SHTËPI, SHITORE, NDËRTESA, SHTALLA, DEPO, ANEKSE, KATE SHTESË, etj. brenda sipërfaqes së komunës / parcelës private, qytetari duhet të aplikoj në Komunë/Drejtorinë e Urbanizmit për LEJE.**

LEJA do të lëshohet nga Komuna / Drejtoria e Urbanizmit duke u bazuar në:

- PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL të Mamushës të miratuar nga komuna më 2014;
- Rekomandimet nga “Doracaku: UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E ZHVILLIMIT në Mamushë”

# KUSHTET NDËRTIMORE

KUSHTET NDËRTIMORE
përcaktojnë llojin, madhësinë, mënyrën e ndërtimit, kushtet e sigurisë, dhe çfarëdo kushti tjetër të domosdoshëm për ndërtime

## SI TË APLIKONI

1. Konsultojeni PZHK-në, propozoni kushtet e ndërtimit dhe aplikoni në Drejtorinë e urbanizmit

2. Zyrtari i Drejtorisë së urbanizmit do të verifikojë nëse kërkesa është e kompletuar

***Nëse jo*** → 2a.Ju do të informoheni nga Drejtoria e urbanizmit dhe personat përgjegjës për shqyrtim për ndryshimet dhe do të duhet t'i ridërgoni dokumentet e korrigjuara dhe të kompletuara në Drejtorinë e urbanizmit

***Nëse po***

3. Personat përgjegjës për shqyrtim do t'i shqyrtojnë kushtet e propozuara ndërtimore

Nëse nuk është në përputhje me PZHK-në dhe kërkesat tjera → 2a

***Nëse është në përputhje me PZHK-në dhe kërkesat tjera***

4. Ju do të informoheni për kërkesën e miratuar përmes telefonit, postës apo emailit

**Brenda 15 dite (kat. I) dhe 30 dite (kat.II dhe III)**





# LEJA NDËRTIMORE

## SI TË APLIKONI

1. Dorëzoni kërkesën për leje ndërtimore në Drejtorinë e urbanizmit

2. Drejtoria e urbanizmit do të pranoj kërkesën

***Nëse nuk është e kompletuar***

2a.Brenda 8 dite (kat.I) dhe 15 dite (kat. II and III) ju do të informoheni nga Drejtoria e urbanizmit për dokumentet që ju mungojnë

2b. Brenda 8 dite (kat I) dhe 15 ditë (kat. II dhe III) kompletoni kërkesën → 1

***Nëse është e kompletuar***

3. Ju do të pranoni një vërtetim me shkrim - aneks 4 & njoftimin mbi taksën

4. Ju duhet të paguani taksën dhe të dorëzoni vërtetimin e pagesës në Drejtorinë e urbanizmit

5. Drejtoria e urbanizmit do të vendosë kërkesën në ueb-faqen e komunës

***Brenda 1 dite***

6. Kërkesa juaj do t'i dorëzohet personave përgjegjës për shqyrtim për të vërtetuar nëse ndërtimi i propozuar është në përputhje me kushtet ndërtimore

***Nëse jo***

6a. Ju do të informoheni nga Drejtoria e urbanizmit dhe shqyrtuesit për mospërputhjet

6b. Ju do t'i korrigjoni mospërputhjet

6c. Paguani taksë shtesë nëse është e nevojshme

6d. Dorëzoni dokumentacionin në Drejtorinë e urbanizmit → 6

***Nëse po***

7. Kërkesa juaj do t'i dorëzohet personave përgjegjës për shqyrtim për të vërtetuar nëse ndërtimi i propozuar është në përputhje me Ligjet dhe Kodin e Ndërtimit

***Nëse jo***

7a. Ju do të informoheni nga Drejtoria e urbanizmit dhe shqyrtuesit për mospërputhjet

7b. Ju do t'i korrigjoni mospërputhjet

7c. Dorëzoni dokumentacionin në Drejtorinë e urbanizmit → 7

***Nëse po***

8. Drejtoria e urbanizmit do të vendos vendimin në ueb-faqen e komunës

9.Drejtoria e urbanizmit do të lëshoj lejen dhe do t'ju informoj përmes telefonit, postës apo emailit

**Brenda 30 dite (kat. I) dhe 45 dite (kat.II & III)**

*Faza e aplikimit*

*Shqyrtimi bazuar në kushtet ndërtimore*

*Shqyrtimi bazuar në Kodin e Ndërtimit*

*Lëshimi i lejes ndërtimore*

LEJA NDËRTIMORE
është dokument i lëshuar nga
KOMUNA/DREJTORIA E URBANIZMIT
për realizimin e ndërtimit brenda parcelës.